



REPUBLIKA E SHOIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 3030 / Prot. 16

Divjakë më 16.04. 2026

THIRRJE

“PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS TË KËSHILLIT BASHKIAK DIVJAKË,
MUAJI PRILL, 2026”

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijeni: **KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË
PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma (a) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, **Ju njoftojmë se: Më datë: 24.04.2026, ditën e Premte, ora 10:00, tek Salla e mbledhjeve, kati i dytë, në Godinën e Bashkisë Divjakë, thirret “Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Prill 2026”. Me këtë Rend dite:**

- 1.Miratim i Rendit të Ditës.
- 2.Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 30.03.2026.
- 3.Information mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Mars 2026.
- 4.**Projekt-vendim Nr. 36, datë, 14.04.2026:** Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6%, për muajin Mars 2026.
- 5.**Projekt-vendim Nr. 37, datë, 15.04.2026:** Për një ndryshim në VKB Nr. 90, datë 29.12.2025 “ Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë,institucioneve në varësi dhe të Njësive administrative për vitin 2026”
- 6.**Projekt-vendim Nr. 38, datë, 15.04.2026:** Për krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë publike në Bashkinë Divjakë dhe miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij.
- 7.**Projekt-vendim Nr. 39, datë, 16.04.2026:** Për transferimin e asetit “ Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësive Administrative Remas” për Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh.A.
- 8.**Projekt-vendim Nr. 40, datë,16.04.2026:**Për një ndryshim në pozicionin e fushave sportive, për projektin “ Rikonstruksion i objekteve ekzistuese, shtesë anësore dhe ndërtim palestre në Shkollën e Mesme të Bashkuar, Remas”, Bashkia Divjakë.
9. **Raport** - Mbi veprimtarinë e Këshillit Bashkiak Divjakë për vitin 2025.
10. **Raport** - Mbi transparencën në Vendimmarrje të Këshillit Bashkiak Divjakë për vitin 2025.

Sqarim: Komisionet përgjegjës sipas pikave në Rendin e ditës janë:-Komisioni i Ekonomisë dhe i financave, për pikat nr: **4,5,7**.- Komisioni i bujqësisë dhe emergjencave civile, për pikën **6**.
-Komisioni i Urbanistikës, Infrastrukturës dhe Strehimit. për pikën **8**.

Duke ju falenderuar !

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Liri Biri

